<p>1.2. kosto e përmirësimit, renovimit dhe rikonstruksionit të mjeteve të cilat janë kapitalizuar dhe zhvlerësuar, nuk do të njihen shpenzim i periudhës, por do të trajtohen në përputhje me nenin 18 të këtij Ligji;</p> <p>1.3. gjobat, ndëshkimet, shpenzimet dhe interesi që lidhet me ato;</p> <p>1.4. tatimi në të ardhura i paguar ose i lindur për periudhën tatimore aktuale ose të mëparshme dhe çdo interes ose ndëshkim i krijuar për pagesë me vonesë të tij;</p> <p>1.5. tatimi në vlerën e shtuar për të cilin tatimpaguesi kërkon zbritje ose kreditim për tatimin e zbritshëm në bazë të legjislacionit për Tatimin në Vlerën e Shtuar;</p> <p>1.6. humbja tatimore nga transaksionet ndërmjet personave të lidhur nuk mund të zbritet, me përjashtim të rasteve kur është në përputhje me vlerën e hapur të tregut;</p> <p>1.7. kontributet pensionale mbi shumën maksimale të lejuar nga legjislacioni përkatës mbi pensionet në Kosovë.</p> <p>1.8. shpenzimet për dhurata, përveç atyre që janë me emër dhe logo të biznesit, të cilat janë pjesë e shpenzimeve të përfaqesimit;</p> <p>1.9. humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit,</p>	<p>1.2. cost of acquisition, improvement, renewal and reconstruction of assets that are depreciated or amortized shall not be considered as expenses of the period, but shall be treated in compliance with Article 18 of this Law;</p> <p>1.3. fines, penalties, expenses and interest related thereto;</p> <p>1.4. income tax paid or incurred for the current or previous tax period or any interest or penalty generated for payment being delayed;</p> <p>1.5. the Value Added Tax for which the taxpayer requests deductions or crediting for the deductible taxation based on Value Added Tax legislation;</p> <p>1.6. tax losses from transactions between the related persons cannot be deducted, except the cases when it is in compliance with the market value;</p> <p>1.7. pension contributions over the maximum amount allowed by the respective legislation on Kosovo pensions.</p> <p>1.8. expenses for presents, other than those with the name and logo of the business, which are part of the expenses of representation;</p> <p>1.9. losses, damages, spillages and discarded parts during production, transport</p>	<p>1.2. troškovi poboljšanja, popravke i obnove sredstava koja su kapitalizovana i amortizovana, neće se priznati troškovi perioda, nego će se tretirati u skladu sa članom 18 ovog zakona;</p> <p>1.3. novčane kazne, kazne, troškovi i kamata u vezi sa tim;</p> <p>1.4. porez na prihod isplaćen ili nastao za sadašnji ili prethodni poreski period i svaka kamata ili kazna nastala za isplatu zbog zakašnjenja;</p> <p>1.5. porez na dodatu vrednost za koji poreski obveznik potražuje povraćaj ili kredit za ukazni porez prema zakonodavstvu poreza na dodanu vrednost;</p> <p>1.6. poreski gubitak od transakcija između povezanih lica ne može da se odbije, sa izuzećem slučajeva kada je u skladu sa vrednošću otvorenog tržišta;</p> <p>1.7. penzijski doprinos iznad maksimalnog dozvoljenog iznosa od dotičnog zakonodavstva o penzijama na Kosovu.</p> <p>1.8. troškovi za poklone, osim onih koji imaju ime i logo biznisa, koji su delovi troškova predstavljanja;</p> <p>1.9. ukoliko tokom poreskog perioda, zajam prekoračuje četiri puta iznos svog kapitala,</p>
--	---	--

<p>përtej normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;</p> <p>1.10. përfitimet në natyrë në formë të shujtës dhe transportit, përveç rasteve kur është e domosdoshme dhe organizohet nga biznesi;</p> <p>1.11. shpenzimet për qiratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve rezident dhe jorezident, pavarësisht nga kushtet e kontratës së punësimit apo shërbimit.</p> <p>1.12. shpenzimet e mbuluara nga grantet, subvencionet dhe donacionet, në harmoni me rregullat dhe kushtet e përfitimit.</p>	<p>and storage, beyond the norms set forth in the special legal and sublegal acts;</p> <p>1.10. benefits in nature in the form of meals and transport tickets, unless it is necessary and is organized by business;</p> <p>1.11. expenses on rents of apartment serving for accommodation and lodging of resident and non-resident employees, irrespective of the terms of contract of employment or service.</p> <p>1.12. expenditure covered from grants, subsidies and donations, in compliance with regulations and earning criteria's.</p>	<p>plaćena kamata o prekoraćenom iznosu se ne priznaje kao umanjeni trošak. Ovo ograničenje se ne primenjuje za banke, kompanije osiguranja i kompanije lizinga;</p> <p>1.10. gubici, oštećenja, ostaci materijala tokom proizvoda, prevoza i deponiranja, preko određenih stopa u posebnim zakonskim i podzakonskim aktima;</p> <p>1.11. davanja u naturi u obliku obroka i prevoza, osim slučajeva kada je to neophodno i kada se organizuje od poslovanja;</p> <p>1.12. troškovi pokriveni od grantova, subvencija i donacija u skladu sa pravilima i uslovima dobijanja.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Shpenzimet e lejueshme</p> <p>1. Në varësi të kufizimeve të këtij Ligji, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto të paguara ose të bëra vetëm gjatë periudhës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkritazi me veprimtarinë e tij ekonomike, përfshirë primet për sigurim shëndetësor, të paguara në interes të punëtorit dhe ato të varura që duhet të përfshihen në polisën e të punësuarit.</p> <p>2. Shpenzimet edukative/arsimore të paguara nga një punëdhënësi në një institucion</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Allowable expenses</p> <p>1. Subject to the limitations in this Law, in determining taxable income, a taxpayer shall be allowed as a deduction from gross income expenses paid or incurred during the tax period wholly and exclusively in connection with its economic activities, including premiums for health insurance paid on the interest of the employee and the dependent ones which are included in the employee's policy.</p> <p>2. Educational expenses paid by an employer in an educational institution for an employee</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Odobri troškovi</p> <p>1. Zavisno od ograničenja ovog Zakona, u utvrđivanju poreza na dohodak, poreskom obavezniku dozvoljava se odbitak od bruto prihoda, plaćenih ili stvorenih u potpunosti tokom poreske periode i isključivo uz svoju privrednu aktivnost, uključujući i zdravstveno osiguranje, plaćeno u interesu zaposlenika i ona zavisna koja treba da budu obuhvaćena u polisi zaposlenih.</p> <p>2. Obrazovni rashodi/ plaćeno školovanje od</p>

<p>edukativ/arsimor për një të punësuar, do të jenë të lejueshme në tërësi në vitin në të cilin shpenzimet e tilla janë paguar, me kusht që:</p> <p>2.1. shpenzimet edukative/arsimore të jenë paguar drejtpërdrejtë në institucionin edukativ/arsimor;</p> <p>2.2. institucioni edukativ/arsimor është i pranuar me legjislacionin përkatës në fuqi në Kosovë;</p> <p>2.3. edukimi/arsimi lidhet me pozitën e të punësuarit dhe nuk e kualifikon atë të punësuar për punë në një profesion tjetër; dhe</p> <p>2.4. i punësuarit mbetet në punësim të punëdhënësi pas përfundimit të edukimit/arsimit, për të cilin shpenzimet janë paguar nga punëdhënësi për një periudhë kohore të specifikuar me akt nënligjor të lëshuar nga Ministri.</p> <p>3. Shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënësi për një të punësuar, që lidhen me punën, të cilat nuk tejkalojnë 1,000 € për trajnime brenda vendit, ndërsa 3,000 € për trajnime jashtë vendit, do të lejohen në tërësi në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur. Shpenzimet që kalojnë limitet, do të konsiderohen shpenzime të lejueshme për biznesin vetëm nëse për diferencën është mbajtur dhe paguar tatimi në burim.</p>	<p>shall be allowable wholly in the year in which such expenses are paid, provided that:</p> <p>2.1. educational expenses are directly paid in the educational institution;</p> <p>2.2. educational institution is recognised by respective legislation applicable in Kosovo;</p> <p>2.3. education relates to the employee's position and does not qualify the employee for work in another position; and</p> <p>2.4. the employee shall be employed by the employer following the completion of education for which the expenses are paid by the employer for a specified time period by means of a sublegal act issued by the Minister.</p> <p>3. Costs of training paid by an employer for an employee work-related, which do not exceed € 1,000 for training within the country, while € 3,000 for training abroad shall be allowed in whole in the year in which such training costs occurred. Costs exceeding limits shall be considered as allowable costs for the business only if the source tax was withheld and paid for the difference.</p>	<p>poslodavca u jednoj obrazovno-edukativnoj ustanovi za zaposlene biće dozvoljeno u potpunosti u godini u kojoj se plaćeni takvi rashodi, pod uslovom da:</p> <p>2.1. obrazovno/ edukativni rashodi da su plaćeni direktno obrazovno-edukativnoj ustanovi;</p> <p>2.2. obrazovno/edukativna ustanova je priznata zakonom koji je na snazi na Kosovu;</p> <p>2.3. obrazovanje/ edukacija odnosi se na poziciji zaposlenog i ne kvalifikuje zaposlenog za rad u nekoj drugoj profesiji ; i</p> <p>2.4. zaposleni ostaje zaposlen kod poslodavca nakon završetka školovanja / obrazovanja za kojeg su rashodi plaćeni za jednu vremensku periodu naznačenu u podzakonskom aktu koji donosi Ministar.</p> <p>3. Troškovi obuke koji su isplaćeni od jednog poslodavca koji se povezuju sa radom, koji neće premašiti hiljadu 1,000 € za obuku unutar zemlje, dok 3,000 € za obuku van zemlje, dozvoliće se u celosti u godini u kojoj ti troškovi su nastali. Troškovi koji prekoračuju limite, smatraće se dozvoljeni troškovi za biznis samo ukoliko za razliku je zadržan i isplaćen porez na izvor.</p>
--	--	--

<p>4. Nëse një tatimpagues, ndryshe nga një tatimpagues i angazhuar në afarizëm për dhënie me qira të pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme, zgjedh të mos mbajë regjistrime të shpenzimeve aktuale të paguara apo të lindura në aktivitetin e qirasë, tatimpaguesit të tillë i lejohet një zbritje nga të ardhurat bruto nga qiraja në një shumë të barabartë me dhjetë përqind (10%) të qirave të pranuar me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të riparimit, arkëtimit të pagesave dhe të shpenzimeve tjera të paguara apo të krijuara gjatë realizimit të qirasë.</p> <p>5. Nuk do të lejohet zbritje për çdo shpenzim të rrjedhë bazuar në një obligim të mbajtjes në burim, përveç nëse shpenzimet e tilla të jenë paguar në ose para 31 marsit të periudhës pasuese tatimore. Çdo shpenzim i palejuar nga ky nën-paragraf do të jetë i zbritshëm në periudhën tatimore në të cilën në të vërtetë është paguar.</p> <p>6. Shpenzimet, përfshirë shpenzimet e zhvlerësimit që lidhen me lizingjet operuese dhe lizingjet financiare, do të raportohen në mënyrën e përshkruar me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p> <p>7. Nuk do të lejohet si zbritje për shpenzimet përveç atyre shpenzimeve të dokumentuara në mënyrën e kërkuar me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri.</p>	<p>4. If a taxpayer, other than a taxpayer engaged in a business for renting out personal estate or real estate, opts not to keep registration of current expenditures paid or incurred in the rent activity, such taxpayers shall be allowed a deduction from gross rent income in an amount equal to ten per cent (10%) of the rents received for the purpose of covering repair expenses, collection of payments and other expenses paid or generated over the course of rent.</p> <p>5. No deduction shall be allowed for any expense incurred based on an obligation of source withholding, unless such expenses are paid on or before 31 March of the subsequent tax period. Any disallowed expense under this sub-paragraph shall be deductible in the tax period in which it is actually paid.</p> <p>6. Expenses, including depreciation expenses with respect to operational leasing and financial leasing, shall be reported in the manner prescribed by a sublegal act issued by the Minister.</p> <p>7. No deduction shall be allowed for expenses, other than the expenses documented in the manner required under the sublegal act issued by the Minister.</p>	<p>4. Ako poreski obaveznik, za razliku od poreskih obaveznika koji obavlja posao iznajmljivanja pokretne i nepokretne imovine, bira da ne vodi evidenciju aktuelnih plaćenih troškova ili stvorenih u delatnosti najma, poreskom obavezniku će biti dozvoljeno da snizi od bruto prihoda od najamnina jednak iznos od (10 %) primljene kirije u cilju izračunavanja odobrenih amortizacija i da bi prekrili troškove popravke, uplate prikupljanja i drugih troškova plaćenih ili nastalih u generisanja prihoda od najma.</p> <p>5. Neće biti dozvoljeno ikakav odbitak za tok izdataka koji se osniva na obavezu održavanja izvora, osim ako se takvi troškovi plaćeni 31 marta ili pre sledeće poreske periode. Bilo koji nedozvoljeni trošak iz ovog zakonskog podatka biće umanjen u poreskoj periodi u kojoj je u stvari uplaćen.</p> <p>6. Troškovi, uključujući i troškove umanjenja vrednosti, koji se povezuju sa operativnim i finansijskim lizinima izveštavaće na način definisan podzakonskim aktom koji donosi Ministar.</p> <p>7. Neće biti dozvoljeno kao odbitak za izdatke, osim onih dokumentovanih na zahtevani način podzakonskog akta koji donosi Ministar.</p>
---	---	---

<p align="center">Neni 10 Zbritjet e lejuara për aktivitetet me interes publik</p>	<p align="center">Article 10 Allowable deductions for public interest</p>	<p align="center">Član 10 Dopuštena umanjnja za aktivnosti od javnog interesa</p>
<p>1. Kontributet e dhëna, nga tatimpaguesit që mbajnë libra dhe regjistrime sipas paragrafit 5 të nenit 35 të këtij Ligji, në formë të donacionit dhe sponsorisimeve për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive sipas këtij Ligji konsiderohen si kontribute të dhëna për interes publik dhe lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej dhjetë për qind (10%) të të ardhurave të tatueshme të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribut.</p> <p>2. Një kontribut i lejueshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet t'i bëhet:</p> <p>2.1. një organizatë të regjistruar sipas legjislacionit përkatës në fuqi mbi themelimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare.</p> <p>2.2. çdo organizatë tjetër që në mënyrë të drejtpërdrejtë kryen aktivitete me interes publik, siç janë:</p> <p>2.2.1. institucionet shëndetësore;</p> <p>2.2.2. institucionet edukativo-arsimore;</p> <p>2.2.3. organizatat për mbrojtjen e mjedisit;</p>	<p>1. Contributions made by taxpayer who keep books and records in accordance with paragraph 5 of Article 35 of this Law, in the form of donations or sponsorship for humanitarian, health, education, religious, scientific, cultural, environmental protection and sports in accordance with this law, are considered as contributions given for public interest and are allowed as a deduction up to a maximum of ten per cent (10%) of taxable income computed before this contributions are deducted.</p> <p>2. An allowable contribution under paragraph 1 of this Article must be made to:</p> <p>2.1. an organization registered under relevant legislation in force on Registration and Function as a Non-governmental organisation.</p> <p>2.2. any other organization that directly perform activities in the public interest, such as:</p> <p>2.2.1. medical institutions;</p> <p>2.2.2. educational institutions;</p> <p>2.2.3. organizations to protect the environment;</p>	<p>1. Prilozi dati od poreskih obveynika koji drže knjige i evidencije predviđene prema stavu 5 člana 35 ovog Zakona, u smislu donacije i sponzorisanja za humanitarne ciljeve, zdravstvene, obrazovno – vaspitne, verske, naučne, i kulturne svrhe, za zaštitu okoline i sport, prema ovom zakonu smatraju se kao doprinosi dati za javni interes i dozvoljeni su kao troškovi maksimalno do deset posto (10%) oporezovanih prihoda izračunatih pre nego je snižen ovaj doprinos.</p> <p>2. Dopušteni prilozi prema paragrafu 1 ovog člana moraju da budu dati:</p> <p>2.1. organizaciji registrovanoj prema zakonodavstvu o osnivanju i funkcionisanju jedne nevladine organizacije</p> <p>2.2. bilo kojim drugim nekomercijalnim organizacijama koje neposredno vrše delatnosti u javnom interesu i kao što su:</p> <p>2.2.1. zdravstvene institucije;</p> <p>2.2.2. obrazovne – vaspitne organizacije;</p> <p>2.2.3. organizacije za zaštitu</p>

<p>2.2.4. institucionet fetare;</p> <p>2.2.5. institucionet që përkujdesen për persona të paaftë apo për persona të moshuar;</p> <p>2.2.6. jetimoret; dhe</p> <p>2.2.7. institucionet në përkrahje të shkencës, kulturës, sportit apo të arteve.</p> <p>3. Zbritja e lejueshme nuk përfshinë kontributin nga i cili direkt apo indirekt përfitojnë donatorët ose personat e afërm me donatorin.</p> <p>4. Secili tatimpagues që kërkon zbritje të lejueshme duhet t'i paraqesë ATK-së fletë dëshminë e pagesës për një zbritje të tillë.</p> <p>5. Përveç zbritjes së lejuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, tatimpaguesit që do të kontribuojnë në fusha të caktuara, do të kenë një lejim shtesë deri në 10% nëse parashihen me ligje të veçanta në Kosovë.</p> <p>6. Për zbatimin e këtij neni Ministri nxjerr akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Shpenzimet e përfaqësimit, reklamës dhe promocionit ekonomik</p> <p>1. Në shpenzimet e përfaqësimit përfshihen shpenzimet me karakter të përgjithshëm që një</p>	<p>2.2.4. religious institutions;</p> <p>2.2.5. institutions that care for disabled or elderly persons;</p> <p>2.2.6. orphanages; and</p> <p>2.2.7. institutions that promote science, culture, sports or arts.</p> <p>3. An allowable deduction shall not include a contribution that directly or indirectly benefit donors or related persons of the donor.</p> <p>4. Any taxpayer who claims an allowable deduction must file prove sheet of paymentn in respect of such deduction.</p> <p>5. Other than the allowable deduction according to paragraph 1 of this Article, taxpayers to contribute to certain areas shall have an additional allowance up to ten per cent 10% if prescribed by special Kosovo laws.</p> <p>6. The Minister shall issue a sublegal act for the purpose of implementation of this Article.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Costs of representation, advertising and economic promotion</p> <p>1. The representation costs include the general character costs that a business person conducts</p>	<p>okoline;</p> <p>2.2.4. verske ustanove;</p> <p>2.2.5. ustanove za staranje o hendikepiranim i starim licima;</p> <p>2.2.6. sirotišta; i</p> <p>2.2.7. ustanove koje promovišu nauku, kulturu, sport ili umetnost.</p> <p>3. Dopushteni odbici ne ukljuuju prilogе koje posredno ili neposredno imaju korist donatori ili lica povezana sa donatorom.</p> <p>4. Bilo koji poreski obveznik koji traži dopušteni odbitak mora da podnosi PAK dokaznu priznanicu o takvom odbitku Poreskoj Administraciji Kosova.</p> <p>5. Osim dozvoljenog odbitka prema stavu 1 ovog člana, poreski obveznici će doprineti na određenim poljima, imaće dodatno dopuštenje do 10% ukoliko se predviđa posebnim zakonima na Kosovu.</p> <p>6. Za primenu ovog člana Ministar će usvojiti podzakonski akt.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Troškovi reprezentacije, reklame i ekonomskom promovisanju</p> <p>1. U troškovima reprezentacije se ukljuuju</p>
--	--	--

<p>person afarist bënë për prezantimin dinjitoz të saj në marrëdhënie me partnerët apo institucionet e tjera, si: organizimi i takimeve, prezantimi i projekteve të reja, përirimi i linjave apo prodhimeve të reja, qerasjet dhe pritje-përcjelljet që lidhen me aktivitetin e biznesit;</p> <p>2. Shpenzimet e përfaqësimit do të jenë të kufizuara në 1% të të ardhurave bruto vjetore.</p> <p>3. Shpenzimet e reklamës dhe promocionit të cilat bëhen përmes formave të ndryshme të informimit, siç janë: televizioni, radio, gazeta, revista, reklama e drejtpërdrejtë, interneti, posterat, afishet, billboardat, reklamat tranzite e të tjera të ngjashme, janë shpenzime tërësisht të zbritshme për qëllime tatimore.</p>	<p>for his/her dignitary presentation in relation to partners or other institutions, such as; organisation of meetings, presentation of new projects, inauguration of new lines or products, treats and related hosting and accompanying business activities;</p> <p>2. Representation costs shall be limited at 1% of gross annual income.</p> <p>3. The advertising and promotion costs, which are done through different forms of information, such as: TV, radio, newspaper, magazines, direct commercials, internet, posters, flyers, billboards, transit commercials and other similar ones are complete expenses deductible for tax purposes.</p>	<p>troškovi opšteg karaktera koje jedno poslovno lice izvršava za njenu reprezentaciju u odnosima sa drugim partnerima ili ustanovama, kao što su: organiziranje sastanaka, prezentacija novih projekata, uvođenje novih linija ili proizvoda, čašćenja i gošćenje-praćenja koja se povezuju sa biznisom;</p> <p>2. Troškovi reprezentacije će biti ograničene na 1% bruto godišnjih prihoda.</p> <p>3. Troškovi reklamiranja i promocije koje se obavljaju kroz razne oblike informisanja, kao što su: televizija, radio, novine, časopisi, direktno reklamiranje, internet, poster, leci, bilbordi, tranzitne reklame i slično, su troškovi koji su u potpunosti umanjene za poreske svrhe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Shpenzimet e Borxhit të keq</p> <p>1. Një borxh i keq konsiderohet shpenzim nëse i plotëson kushtet vijuese:</p> <p>1.1. pagesa nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht dhe është shpallur si i pambledhshëm duke inicuar procedurat në organet gjyqësore;</p> <p>1.2. borxhit i kanë kaluar së paku gjashtë muaj nga afati i obligimit për pagesë;</p> <p>1.3. shuma që korrespondon me borxhin më herët është përfshirë në evidenca kontabël si e ardhur;</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Bad debts costs</p> <p>1. A bad debt shall be considered an expense if it meets the following conditions:</p> <p>1.1. payment has not been received in whole or in part and has been announced as uncollectable thus initiating procedures with judicial bodies;</p> <p>1.2. the debt is at least six months overdue from its obligation for payment;</p> <p>1.3. the amount that corresponds to the debt has previously been included in accounting evidence as income;</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Loši dugovi</p> <p>1. Loš dug smatra se troškom ako udovoljava sledećim uslovima::</p> <p>1.1. isplata nije izvršena u potpunosti ili delimično i izjavljivan je neprikupljiv, uz pokretanje procedura u sudskim ustanovama;</p> <p>1.2. dug je stariji od najmanje šest meseci od roka obaveze za isplatu;</p> <p>1.3. iznos koji korespondira sa dugom ranije je uključen u evidencije računovodstva kao prihod;</p>

<p>1.4. nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;</p> <p>1.5. ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit sikurse janë:</p> <p>1.5.1. tatimpaguesi ka thyer (balancuar) çdo borxh të pakontestueshëm kundrejt borxhit të keq;</p> <p>1.5.2. korrespondenca dhe kontaktet në përpjekje për të vjelë borxhin;</p> <p>1.5.3. kërkesa është dorëzuar mbi mjetet e falimentimit/likuidimit, nëse është e aplikueshme dhe shuma që do të merret është përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga administratori/përmbaruesi. Deri në shkallën sa janë marrë nga falimentimi, janë aplikuar në borxhin e pashlyer.</p> <p>1.6. tatimpaguesi duhet të lëshojë një faturë për shumën e paarkëtuar ku duhet të shkruhen fjalët “Borxh i keq” si dhe numri i faturës, me të cilën lidhet ky borxh, faturë, e cila i shërben shitësit për të zvogëluar të ardhurën dhe blerësit për të zvogëluar shpenzimin-koston.</p> <p>2. Zbritjet e borxhit të keq janë të kufizuara në pjesën e pambuluar të borxhit. Çdo borxh i keq</p>	<p>1.4. there is no dispute on the legal validity of debt;</p> <p>1.5. there is sufficient evidence that there were substantial attempts made to collect debt, including any applicable action to maximise the debt collection, such as:</p> <p>1.5.1. taxpayer has balanced any indisputable debt against the bad debt;</p> <p>1.5.2. correspondence and contacts as an attempt to collect debt;</p> <p>1.5.3. a request has been submitted on the funds of bankruptcy/liquidation, if applicable and the amount to be received has been reasonably determined by the administrator/ executor. They are applied to the unpaid debt to the extent they are received from bankruptcy.</p> <p>1.6. taxpayer must issue an invoice on the uncollected amount which must write “Bad debt” and the number of invoice with respect to this debt, an invoice which shall serve to the vendor to decrease income and to the purchaser to decrease expenditures – costs.</p> <p>2. Deductions of bad debts are limited to the uncovered part of the debt. Any bad debt</p>	<p>1.4. nema spora oko pravnoj valjanosti duga;</p> <p>1.5. procenataje dovoljne evidencije da su napravljena suštinska zalaganja za prikupljanje duga, uključujući svaku primenljivu akciju za maksimalizaciju prikupljanja duga, kao što su:</p> <p>1.5.1. poreski obveznik je balansirao svaki neosporeni dug naspram lošeg duga;</p> <p>1.5.2. korespondencija i kontakti u pokušavaju da se naplati dug;</p> <p>1.5.3. zahtev je dostavljen o sredstvima bankrotstva /likvidacije, ukoliko je primenljivo i iznos koji će se dobiti je određen na opravdan način od administratora/sudskog izvršitelja. Do stepena koliko je dobiveno od bankrotstva, primenjene su na neotpisani dug.</p> <p>1.6. poreski obveznik će izdati jedan račun za neinkasirani iznos gde će se napisati “Loš dug” kao i broj računa, kojim se povezuje ovaj dug, račun, koja služi prodavcu za umanjenje prihoda i kupcu za umanjenje troška.</p> <p>2. Umanjenje lošeg duga je ograničeno u nepokrivenom delu duga. Svaki odbijeni loš</p>
---	---	---

<p>i zbritur si një shpenzim dhe pastaj është mbledhë, do të përfshihet në të ardhurat e tatimpaguesit në kohën e mbledhjes.</p> <p>3. Shuma e paarkëtuar nuk do të konsiderohet borxh i keq nëse:</p> <p>3.1. transaksionet me të njëjtin borxhli janë përsëritur pas shpalljes së borxhit të keq;</p> <p>3.2. borxhi i keq është ndërmjet palëve të lidhura;</p> <p>3.3. nuk ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit;</p> <p>3.4. kanë kaluar mbi 24 muaj nga data e obligimit për pagesë.</p> <p>4. Në rastin e bankave, degëve të bankave të huaja dhe subjekteve financiare jo bankare, të licencuara nga BQK-ja për ushtrimin e veprimtarisë së kredidhënies, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, fshirja e borxhit të keq, lidhur me procesin e kredidhënies, njihet si shpenzim i zbritshëm me plotësimin e këtyre afateve:</p> <p>4.1. treqind e gjashtëdhjetë e pesë ditë (365) pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit të ekzekutimit të detyrueshëm të përmbaruesi, në rast se kredia është e</p>	<p>deducted as expenditure and then collected shall be included in the taxpayer's income at the time of collection.</p> <p>3. Uncollected amount shall not be considered as bad debt if;</p> <p>3.1. transactions with the same debtor have been repeated after the announcement of bad debt;</p> <p>3.2. bad debt is between the related parties;</p> <p>3.3. there is no sufficient evidence that there were substantial attempts made to collect debt, including any applicable action to maximise the debt collection;</p> <p>3.4. there is 24 months overdue from the obligation for payment.</p> <p>4. In the case of banks, foreign bank branches and non-banking financial entities licensed by CBK for exercising the lending activity, in determining the taxable profit, write-off of bad debt with respect to the lending process is recognised as deductible expenses upon meeting these terms:</p> <p>4.1. three hundred and sixty-five (365) days following the submission of request for the commencement of the proceeding of obligatory execution with the executor, in</p>	<p>dug kao trošak i zatim prikupljen, uključice se na prihode poreskog obveznika u vremenu prikupljanja.</p> <p>3. Ne inkasirani iznos neće se smatrati lošim dugom, ukoliko:</p> <p>3.1. transakcije sa istim dužnikom se ponovilo nakon objavljivanja lošeg duga;</p> <p>3.2. loš dug između povezanih stranaka;</p> <p>3.3. nema dovoljne evidencije da su obavljene suštinska nastojanja za prikupljanje duga, uključujući svaku primenljivu meru za maksimalizaciju prikupljanja duga;</p> <p>3.4. prošli su 24 meseci od datuma obaveze za isplatu.</p> <p>4. U slučaju banaka, bankarskih ogranaka i finansijskih ne bankarskih subjekata, licenciranih od CBK za sprovođenje delovanja davanja zajmova, u određivanju oporezive dobiti, otpis lošeg duga, u vezi sa procesom pozajmljivanja, prepoznaje se kao umanjeni trošak u ispunjenju ovih rokova:</p> <p>4.1. trista šesdeset i pet dana (365) nakon dostave zahteva za početak procesiranja prinudnog izvršenja kod sudskog izvršitelja, u slučaju sa zajam je osiguran pokretnom ili</p>
--	---	---

<p>siguruar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme;</p> <p>4.2. treqind e gjashtëdhjetë e pesë ditë (365) ditë pas lëshimit nga Gjykata të urdhërit të ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e garantuar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme.</p> <p>5. Ministri nxjerr akt nënligjor për të përshkruar kërkesat për zbritjen e borxhit të keq sikur që është paraparë me këtë nen.</p>	<p>case the loan has been secured with personal estate or real estate;</p> <p>4.2. three hundred and sixty-five (365) days following the issuance of Court Order for execution, in case the loan has not been secured with personal estate or real estate;</p> <p>5. The Minister shall issue a sublegal act to describe requests for the deduction of bad debt as is prescribed under this Article.</p>	<p>nepokretnom imovinom;</p> <p>4.2. trista šesdeset i pet dana (365) nakon izdavanja sudskog izvršenja od Suda, ukoliko zajam nije garantiran pokretnom ili nepokretnom imovinom;</p> <p>5. Ministar usvaja podzakonski akt radi opisivanja zahteva za umanjenje lošeg duga kao što je predviđeno ovim članom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Fondet rezervë</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Reserve funds</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Rezervni fondovi</p>
<p>1. Përveç nëse është paraparë ndryshe në këtë ligj, kontributet në fondet rezervë nuk lejohen si shpenzime.</p> <p>2. Institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës, ndryshe nga ato të ardhura që dalin nga sigurimi i jetës, pasurisë, apo rreziqeve tjera, kanë të drejtë në shpenzime për krijimin e fondit të posaçëm rezervë për mjetet e dyshimta të tyre në shumën e cila nuk duhet të kalojë shumën maksimale të lejueshme nga Banka Qendrore e Kosovës. Nëse një institucion financiar është i angazhuar edhe në aktivitete bankare edhe në ato të sigurimit, shpenzimet për fondin rezervë janë të lejueshme vetëm në raport me mjetet e dyshimta që dalin nga aktivitetet bankare.</p> <p>3. Pas krijimit të fondit të posaçëm rezervë, çdo shumë e tërhequr prej fondit duhet të përfshihet</p>	<p>1. Except as otherwise provided in this Law, contributions to reserve funds are not allowable as an expense.</p> <p>2. Financial Institutions licensed by Central Bank of Kosovo, other than that income deriving from life insurance, assets, or other risks, are entitled to expenditures for the creation of special reserve fund for their suspicious funds in the amount which shall not exceed the maximum allowable amount by Central Bank of Kosovo. If a Financial Institution has also been engaged both in banking activities and in insurance activities, expenses for the reserve fund are allowable only with respect to suspicious funds deriving from banking activities.</p> <p>3. Subsequent to the creation of the special reserve fund, any amount withdrawn from the</p>	<p>1. Samo ako je drugačije predviđeno ovim Zakonom, odvajanje sredstava u rezervu nije dopušteno kao trošak.</p> <p>2. Finansijske institucije licencirane od Centralne Banke Kosova, drukčije od onih prihoda koji nastaju od osiguravanja života, imovine ili drugih rizika, imaju pravo potrošnje za formiranje posebnih rezervnih fondova o njihovim sumnjivim sredstvima u iznosi u koji ne treba prekoračiti odobreni maksimalni iznos iz centralne Banke Kosova. Ako je finansijska institucija angažovana i u bankarskim i osiguravajućim aktivnostima, rashodi za rezervni fond odobreni su samo u vezi sa sumnjivim sredstvima koja proizlaze od bankarskih aktivnosti.</p> <p>3. Posle osnivanja posebnog rezervnog fonda, svaki iznos podignut iz fonda treba da se</p>

<p>në të ardhura dhe në çdo shumë të kthyer në fond për ta rimbushur atë deri në shumën e lejueshme që lejohet si zbritje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Pagesat për personat e lidhur</p> <p>1. Kompensimi ose pagat e paguara për personin e lidhur lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me vlerën e hapur të tregut.</p> <p>2. Interesi, qiraja dhe shpenzimet tjera që i paguhen personave të lidhur lejohen si shpenzime në shumën e barabartë me vlerën e hapur të tregut.</p>	<p>fund shall be included in income and any amount placed back into the fund, to replenish it to the allowable amount, shall be allowed as a deduction.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Payments to related persons</p> <p>1. Compensation or emoluments paid to a related person shall be allowed as an expense in an amount equal to the market value.</p> <p>2. Interest, rent, and other expenses paid to a related person shall be allowed as an expense in an amount equal to the market value.</p>	<p>uključujući u prihode i na svaki vraćeni iznos u fond za ponovno popunjavanje do dozvoljenog iznosa dopusta se kao smanjene.</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Plaćanje povezanim licima</p> <p>1. Naknada ili plate isplaćene povezanim licima dozvoljena je kao trošak u iznosu jednakom aktuelne minimalne plate ili otvorene tržišnoj vrednosti.</p> <p>2. Kamata, najam i drugi troškovi plaćeni povezanim licima dopušteni su kao trošak u iznosu jednakom aktuelne minimalne plate ili otvorene tržišnoj vrednosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Zhvlerësimi</p> <p>1. Shpenzimet për pronën e prekshme përveç shpenzimeve për tokën, veprat artistike dhe pronën tjetër e cila nuk konsumohet që i posedon tatimpaguesi dhe që shfrytëzohen për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit, do të kompensohen me kalimin e kohës përmes zbritjeve të zhvlerësimit në mënyrën e përcaktuar me këtë nen.</p> <p>2. Shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periudhën e kohëzgjatjes së qirasë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Depreciation</p> <p>1. Expenditures on tangible property, other than expenditures for land, works of art, and other property which are not subject to wear, owned by the taxpayer and used for the taxpayer's economic activity, shall be recovered over time by depreciation deductions in the manner prescribed by this Article.</p> <p>2. Expenditures on improvements to leaseholds used for the taxpayer's economic activity shall be recovered through depreciation deductions calculated using the straight-line method with a period equal to the life of the leasehold.</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Amortizacija</p> <p>1. Troškovi u vezi sa materijalnom imovinom, osim troškove za zemljište, radove ili umetnička dela, i za drugu imovinu koja nije podložna habanju, koju poseduje poreski obveznik i koja se koristi za poslovanje poreskog obveznika, izuzima se postupno pomoću odbitaka za amortizaciju na način propisan ovim Članom.</p> <p>2. Troškovi poboljšanja najmljene imovine korišćene za poslovanje poreskog obveznika izuzimaju se pomoću odbitaka za amortizaciju obračunatim pravolinijskim postupkom za period jednak roku trajanja najmljene imovine.</p>

<p>3. E gjithë prona e prekshme e tatimpaguesit që i nënshtrohet zhvlerësimit sipas këtij neni caktohet në një rën prej kategorive vijuese:</p> <p>3.1. kategoria 1 - ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore;</p> <p>3.2. kategoria 2 - automobilat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobilet dhe pajisjet për zyra, instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjera shtesë, dhe bagëtitë e shfrytëzuara për prodhim ose për mbarështim;</p> <p>3.3. kategoria 3 - uzinat dhe makineria; inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor; aeroplanët; anijet dhe bimët shumë vjeçare dhe shkurret e shfrytëzuara për vreshtari ose për prodhimin e frutave si p.sh. mollët, dardha, arrat, boronicat dhe të tjera; dhe të gjitha asetet e prekshme që nuk janë përfshirë në Kategorinë 1 apo Kategorinë 2 të këtij paragrafi.</p> <p>4. Shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore përcaktohet duke aplikuar përqindjet e mëposhtme në mënyrë individuale të pronës së prekshme individuale sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore sipas kategorisë së cilës i përkasin asetet:</p>	<p>3. All tangible property of the taxpayer that is subject to depreciation under this article shall be placed in one of the following categories:</p> <p>3.1. category 1: Buildings and other construction structures;</p> <p>3.2. category 2: Automobiles and light trucks, lights vehicles for transport, equipment for transport of soil, bulldozers, digging machines and other heavy machines, computers, peripherals, and other data processing equipment, office furniture and office equipment, instruments, sundries and other accessories; and livestock used for production and breeding;</p> <p>3.3. category 3: Plant and machinery, rolling stock and locomotives used for railway transport; airplanes, ships and multi-annual plants and bushes used for viniculture or for production of fruits such as: apples, pears, nuts, blueberries and so forth; and all tangible assets which are not included in category 1 or category 2 of this paragraph.</p> <p>4. The amount allowed as a depreciation deduction for the tax period shall be determined by applying the following percentages individually to the tangible property according to straight-line method at the close of tax period according to the category assets are belonging to:</p>	<p>3. Sva materijalna imovina poreskog obveznika podložna amortizaciji prema stavu ovom članu spada u jednom od sledećih kategorija:</p> <p>3.1. kategorija 1: Zgrade i druge građevinske strukture;</p> <p>3.2. kategorija 2: automobili i laki kamioni, računari, vozila za teški transport, građevinske mašine, buldožeri, kompjuteri i druga prema za obradu podataka, kancelarijski nameštaj i kancelarijska oprema, instrumenti, drugi pribor i druga dodatna prema; i stoka korišćena za reprodukciju;</p> <p>3.3. kategorija 3: postrojenja i mašine; vagoni i lokomotive za železnički transport, avioni, brodovi i višegodišnje biljke i žbunjevi korišćene za vinogradarstvo ili za proizvodnju voće, n.p. jabuke, kruške, orah, borovnice i druge i sva druga sredstva koja nisu obuhvaćena u 1 ili 2 kategoriju ovog stava.</p> <p>4. Usvojen iznos kao smanjenje za amortizaciju u poreskom periodu utvrđuje se primenjivanjem dolje navedene procenete za kapitalna individualna sredstva takve kategorije po linearnoj metodi na kraju poreskog perioda:</p>
---	---	--

<p>4.1. Kategoria 1- pesë përqind (5%);</p> <p>4.2. Kategoria 2- njëzet përqind (20%); dhe</p> <p>4.3. Kategoria 3- dhjetë përqind (10%).</p> <p>5. Një pasuri për aspekte zhvlerësimi merret parasysh kur vihet për herë të parë në shërbim/përdorim.</p> <p>6. Shuma fillestare që do të zhvlerësohet do të jetë çmimi i blerjes apo, në mungesë të çmimit të blerjes, çmimi i kostos. Shuma fillestare do të përfshijë:</p> <p>6.1. Detyrimet tatimore, ngarkesat, taksat dhe kamatat që i ngarkohen kësaj pasurie para se të vihet në shërbim pasuria;</p> <p>6.2. Shpenzimet e rastit sikurse janë provizioni, paketimi, transporti dhe shpenzimet e sigurimit të ngarkuara nga furnizuesi.</p> <p>7. Pasuritë kapitale që janë blerë dhe kanë filluar të zhvlerësohen sipas metodës së grupimit para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave, do të vazhdojnë të zhvlerësohen sipas legjislacionit të mëparshëm derisa vlera e grupit të bëhet zero.</p> <p>8. Blerja e një pasurie për çmimin deri në 1,000 € do të lejohet si shpenzim rrjedhës, me përjashtim kur pasuria funksionon si pjesë e një tërësie dhe vlera e tërësisë kalon mbi 1,000 €.</p>	<p>4.1. Category 1- five per cent (5%);</p> <p>4.2. Category 2- twenty per cent (20%); and</p> <p>4.3. Category 3- ten per cent (10%).</p> <p>5. An asset shall first be taken into account for the purpose of depreciation aspects when it is first placed into service/use.</p> <p>6. The initial amount to be depreciated shall be the price of purchase or, in absence of the price of purchase, the price of cost. The initial amount includes:</p> <p>6.1. Tax liabilities, charges, fees and interests charged to this asset before the asset is placed into service/use;</p> <p>6.2. Incidental expenses such as provision, packaging, transport and insurance expenses charged by the supplier.</p> <p>7. Capital assets purchased and commenced to depreciate according to grouping method before the Law No. 03/L-162 on corporate income tax entered into force shall continue to depreciate according to previous legislation while the group value becomes zero.</p> <p>8. Purchase of an asset with the price of up to € 1,000 shall be allowed as current expenditure, with the exception of when the asset functions as part of one entirety and the value of entirety</p>	<p>4.1. Kategorija 1: pet procenata (5%);</p> <p>4.2. Kategorija 2: dvadeset procenata(20%); i</p> <p>4.3. Kategorija 3: deset procenata (10%).</p> <p>5. Prema ovom članu, imovina biva prvi put uzeta u obzir kad je prvi put upotrebljena.</p> <p>6. Početan iznos koja se amortizuje čini njena cena nabavke ili, u nedostatku nabavne cene, cena koštanja. Početni iznos takođe uključuje:</p> <p>6.1. Poreske obaveze, dažbine, takse i kamate koje se nameću toj imovini pre uvođenja imovine u upotrebi;</p> <p>6.2. Tekući trošak kao na primer one za komisiju, pakovanja, transporta i troškovi osiguranja opterećen od snabdevača.</p> <p>7. Kapitalna imovina (sredstva) koja su kupljena, i započelo je obescenjivanje prema metodi grupisanja pre stupanja na snagu Zakona br. 03/L-162 za porez na dobit korporacija, nastaviće se da ostanu obescenjani prema ranijem zakonodavstvu dok je vrednost grupe jednaka sa nula.</p> <p>8. Kupovina imovina sredstva za cenu od hiljadu 1.000 evra dozvoljava se kao tekući trošak, sa izuzetkom kada imovina funkcioniše kao deo jedne celine i vrednost celine</p>
---	---	---

